



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2019:105216

Datë: 11.11.2020

Numri i dokumentit: 01264263

P.nr.217/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të pandehurit Rr.I., me vendbanim në fsh.T., Komuna L., të cilën e akuzon PTH në Prishtinë me aktakuzën saj PP.II.nr.3499/2016, të dt.09.03.2017, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me dt.06.11.2020, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurores Ajshe Ferati, të akuzuarit, dhe mbrojtësit të t'akuzuarit Sh. S. av. ne L., në të njëjtën datë, merr dhe publikisht shpallë këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

Rr.I., i lindur me datën në fshatin T. K.L., nga i ati B. dhe e ëma H., i vajzërisësë I., me numer personal, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 15.02.2016, në objektin N.T.P "R.", në fshatin T. K.L., i pandehuri me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme është hasur në lokalin e tij duke e shfrytëzuar energjin elektrike në mënyrë të pa autorizuar, gjatë kontrollës së realizuar nga zyrtarët e KEDS-it, në atë mënyrë që gjatë kontrollit të pikës matëse kanë gjetur njuhësorin e ndaluar, duke mos e regjistruar energjin e konsumuar në këtë objekt, atëherë zyrtarët e KEDS-it kanë ndaluar komplet furnizimin përmes ndarësit 10/0.4,Kv, më pas i pandehuri ka aktivizuar njuhësorin me qëllim që rryma e shpenzuar të mos regjistrohet dhe të mos faturohet fare me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 4.019.45.-€.-

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 3, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, dhe neni 314 par.6 lidhur me apr. 1 të KPRK-së, si dhe dispozitave të neni 365 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me :

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 2000.-€ (dymijëeuro), të cilin ka për detyrë ta paguaje në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi në të kundërtën dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ku për një ditë burgimi do t'i llogaritet shuma prej 20.-€ .

Detyrohe i pandehuri që të dëmtuarës KEDS-i sh.a Prishtinë ti'a kompenzoj dëmin material ne vler prej 4.019.45.-€ ne afat prej 15 dite pas plotfuqishmeris se aktgjykimit nen kercnimin e përmbarimit të dhunshëm.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të i'a paguajë shumën prej 50.-€, në Fondin e viktimave të krimit shumen prej 30.-€, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.3499/16, të dt.09.03.2017, e ka akuzuar të akuzuarin Rr.I.,nga fshati T., Komuna L., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së dhe ne shqyrtimin fillestar Prokuroria e ka rikualifikuar emërtimin ligjor te veprës penale sipas Kodit me te favorshëm per te pandehurin dhe ate per veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 te KPRK-së.

Prokurorja e shtetit në deklaron se mbetet ne tersi pran aktakuzës se ushtruar me shkrim kundër te pandehurit Rr.I.t per veprën penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sepse gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dëshmitarët B. G. dhe I. H. në mënyr te qartë sqaruan se si e kanë gjetur njuhësorin e ndaluar ne ditën kritike dhe duke mos e regjistruar energjin e konsumuar në objektin "R." pronar i së cilës është i pandehuri gjithashtu edhe nga provat materiale të cilat jan shqyrtuar dhe administruar nga kjo gjykatë u vërtetua se kryers i kësaj vepre penale eshte Rr.I., vepër kjo e kryer në dëm te KEDS-it te cilës i ka shkaktuar dëm material ne vler prej 4.019.45.-€, andaj ka kërkuar nga kjo gjykatë që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit .

Në fjalën perfundimtare përfaqësuesi i palës se dëmtuar ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, dhe ka shtuar se i kanë paraqitur prova te mjaftueshme gjykatës qe te akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta obligoj ta paguaj demin e shkaktuar te precizuar ne faturë.

Në fjalën perfundimtare mbrojtësi i te akuzuarit ka shtuar se e kundërshton aktakuzën si te pabazuar dhe te pambështetur ne prova, duke shtuar se aktiakuzues si prova përmban emrat e dy deshmitaerev te cilët u dëgjuan ne shqyrtimin gjyqësor dhe te cilët deklaruan se te njuhësori i klientit te tij nuk eshte gjetur ndonjë paisje qe kishte me ndaluar regjistrimin e njuhësorit elektrik, njuhësori elektrik nuk ka asnjë lloj ndërhyrje per qka kishte me ndikuar ne mos regjistrimin e shpenzimeve te energjisë elektrike si dhe te njëjtit deklaruan se njuhësori nuk eshte marre per te dërguar për ekzaminim ne kalibrim dhe duke filluar nga përshkrimi qe eshte dbere ne kallëzimin penal e deri te dispozitivi i aktakuzës i teri eshte vetëm supozim pasi qe ne kete qeshtje penale aktit akuzues i mungon prova materiale nga instituti i kalibrimit e qe kishte me vërtetu se ne njuhësorin elektrik ka pasur ndërhyrje apo nuk ka pasur andaj gjykatës i ka propozuar qe aktakuzën e prokukorise ta refuzoj si te pa bazuar, ndërsa klientin e tij ta liroj nga përgjegjësia penale.

Ne fjalën perfundimtare i akuzuari ka deklaruar se e mbështet ne tërësi fjalën perfundimtare te mbrojtësit te tij dhe e ndien veten te pafajshëm.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje juridiko-penale, gjykata bëri administrimin e provave me dëgjimin e dëshmitarëve I. H. nga fsh. K. K. S., B. G. nga fsh. D. K. P., me shiqimin dhe leximin e procesverbalit nr.9033733 e dt.15.02.2016, me shiqimin dhe leximin e faturës per rikthimin e humbjeve se bashku me shkresen e kalkulimit ted t.10.03.2016, me shiqimin dhe leximin e shkreses analiza e konsumit se bashku me fotot te vendit te ngjarjes, e të cilat prova gjykata i administroi dhe i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe nenin 361 të KPPK-së, ashtu që gjykata me ndërjegjëje i vlerësoj çdo provë veç e veç dhe të gjitha bashkarisht e të cilave gjykata ua fali besimin ku u vërtetua në mënyrë bindëse se i akuzuari Rr.I. nga fsh. T. K. Lipjan, ka kryer vepren penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, respektivisht në mënyrë bindëse u vërtetua gjendja faktike si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi.

Kete gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga dëgjimi i dëshmitarit I. H., i cili ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike me dt.15.02.2016, ka qenë prezent ne kompaninë "R." gjatë kontrollës ne fsh. T. dhe ka qenë sebashku me ekipen B. G., N. Zh., E. H.i dhe F. Q. dhe se ditën kritike janë nisur per te vendi i ngjarjes ne baze te urdhëresës te AMR-së, dhe ditën kritike ne

momentin e vërejtjes se çrregullimeve nga kontrolla e AMR-së, pas vërejtjes se çrregullimeve kanë marrë informatën se ky njehesor te i akuzuari nuk eshte duke regjistruar energjinë që eshte duke e konsumuar dhe me te pranuar informatën ekipa eshte nis per vendngjarje dhe atë qe e kanë vërejtur nga AMR-ja, te njëjtit kanë dalur per ta vërtetuar fizikisht ne teren ku kanë konstatuar qe njehesori eshte i ndalur dhe nuk eshte duke e regjistruar energjinë qe eshte duke u konsumuar nga i akuzuari ne ate kohë. Me tutje ka shtuar se njehesori ishte i ndalur ndërsa mjetet punuese ishin të gjitha funksionale dhe i kanë përdorur Amperdanet të cilat i kanë vendosur ne dalje te njehesorit pra te përquesit e rrymës elektrike ne dalje te njehesorit ku me këto mjete eshte vërtetuar ne vendngjarje se energjia elektrike ka kaluar te konsumatori pa u regjistruar te njehesori. Se ka mjete teknologjike te adaptuar me te cilat mund te ndërhyhet ne sistemin e njehesorit dhe pa intereenuar komplet me e ndal tensionin njehesori nuk aktivizohet dhe ditën kritike pasi e kanë vërejtur keqpërdorimin e kanë çkyq tensionin dhe kanë aktivizu njehesorin menjëherë kanë kontaktuar me zyretarët e AMR-së ku kanë marrë njoftimin se eshte funksionalizu sistemi dhe pasi kanë marrë përgjigje pozitive janë larguar nga vendi. Pra ndërhyrje fizike ne vend nuk kanë vërejtur por ndërhyrje me mjete siq kanë theksuar me lartë dhe se në kësi raste fare nuk ka nevojë njehesori te dërgohet ne kalibrim pra te ndërhyrjet elektronike ndërsa te ndërhyrjet fizike njehesori dërgohet ne kalibrim.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi edhe nga dëgjimi i dëshmitarit tjetër B. G. i ciline shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike me dt.15.02.2016, ka qenë prezent gjatë kontrollës se bashku me I. H., E. H., F. Q. dhe N. Zh., dhe ne vendngjarje kanë shkuar ne bazë te urdhëresës se AMR-së, per shkak se ky shërbim i kontrollon pikat matëse apo shpenzuesit e mëdhenjë nga qendra ne mënyrë digjitale kur kanë shpenzime dhe kur mund te ndalën dhe për kete shkak AMR-ja ka vërejtur se te konsumatori i lartecukur eshte duke u ndalur njehesori here pas here dhe per kete shkak na ka dërguar si ekip te kontrollës kur ata kanë vërejtur se momentalisht njehesori eshte i ndalur, ne vendin e ngjarjes kur kanë shkuar njehesori ka qenë i ndalur dhe kete mund te shihni ne fotot ne displayn e njehesorit dhe ne ketë rast ne kabllin të cilët shkojnë te konsumatori i kanë futur Amperdanat për matjen e energjisë elektrike momentale sesa po tërheq energji ne çdo fazë dhe janë cekur ne procesverbal se sa ampera po tërheqë secila faze e njehesorit elektrik. Po ashtu ka shtuar se pasi eshte vërejt kjo gjendje e kanë bere fotografimin e njehesorit, kanë bere fotografimin e amperdanave se sa energji eshte duke u shpenzuar dhe eshte formulu procesverbali i vendit te ngjarjes dhe eshte ndalur energjia per ta ristartuar njehesorin elektrik ne komunikim me AMR-në. Po ashtu ka shtuar se ditën kritike ne vendngjarje nuk kanë gjetur ndonjë paisje te njehesori i klientit dhe ka shtuar se nuk ka pasur ndërhyrje fizike te njehesori dhe po ashtu njehesori nuk eshte marrë për tu dërguar ne kalibrim ngase ndërhyrja eshte bere nga nje mjet pa kontakt fizik ne menyre digjitale dhe kësi mjeti kemi hasur ne raste tjera qe ndalet njehesori dhe nuk e regjistron energjinë e shpenzuar.

Nga procesverbali nr.9033733 dt.15.02.2016, vërtetohet se ekipa e kontrollës të firma N.T.P “R.” me seli ne fshatin T. pronar i te cilit eshte Rr.I., me datën e larte cekur ka dalur ekipa e kontrolles ne teren per ta kontrolluar njehesorin e energjisë elektike dhe ne kete rast kanë konstatuar se njehesori eshte i ndalur dhe pas këtyre konstatimeve e kanë ristartuar sistemin duke e aktivizuar njehesorin elektrik.

Lartësinë e dëmit material gjykata e vërtetoi nga fatura e rikthimit te humbjeve e dt.10.03.2016, dhe shkresa e kalkulimit te rikthimit te humbjeve e te njejtës datë ku ne bazë te kalkulimeve qe janë bere mbi bazën e mjeteve dhe paisjeve qe shpenzon energji elektike i akuzuari për periudhën konstestuese e cila periudhe caktohet ne baze te akteve te brendshme te palës se dëmtuar, KEDS-it i eshte shkaktuar dem material ne vlerë prej 4.019.45.-€.

Gjithashtu gjendjen faktike gjykata e ka vërtetuar edhe ne baze te shkresës se quajtur analiza e konsumit se bashku me fotot e vendit te ngjarjes ku nga kjo shkrese e analizës se konsumit vërtetohet se fuqia maksimale vjetore te i akuzuari eshte prej 56.844 KW dhe ne bazë te saj edhe eshte bere matja e rikthimit te humbjeve ndërsa nga fotot e vendit te ngjarjes shihet

qartë se njehesori ka qenë jo funksional ditën kritike pra i ndalur ndërsa Amperdanat e vendosura ne kabllot dalëse nga njehesori ne secilën fazë shihet se energjia elektrike ka qenë duke u shpenzuar ndërsa fare nuk eshte regjistruar ne njehesorin elektrik.

Nga provat e lartpërmendura të cilave gjykata i'u fali besimin u vertetuan te gjitha faktet kontestuese qe jane me rendesi ne kete qeshtje penale respektivisht u vërtetua gjendja faktike si ne dispozitiv te aktakuzes, pra u vërtetua fakti se i akuzuari si pronar i firmes N.T.P "R." ne fsh. T. K. L., ka shfrytëzuar energjine elektrike ne menyre te kundërligjshme me qëllim te perfitimit te dobise pasurore e ka ndalur njehesorin elektrik ne menyre qe energjia e shpenzuar te mos regjistrohet dhe gjykata përtej qdo dyshimi te bazuar mirë vjen në përfundim se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e vepres penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe se në rastin konkret nuk ekzistojnë rrethanat që e përjashtojnë, zvoglojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit apo rrethana qe e pengojnë ndjekjen penale, andaj gjykata te njejtin e shpalli fajtorë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe i shqiptoi dënim me gjobë ne lartesi prej 2.000.-€ në kuader te minimumit dhe te maksimumit te dënimit te paraparë për kete veper penale.

I akuzuari në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se njehesori eshte vendosur larg oborrit te fabrikes në distanc prej 100 m, dhe se është i vendosur ne trafo të fshatit dhe sigurisht ka edhe ndonjë njehesor tjetër, në ditën kritike kur ka ardhur kontrolla nuk ka qenë prezent por djali tij po, po ashtu ka shtuar se asnjeher nuk ka nderhyrë dhe kurrë nuk e ka prekur njehesorin me ndonjë mjet, si dhe qdo muaj e ka paguar faturen e shpenzimeve ne menyre te rregullt, më tutje ka shtuar se djali i tij pas nje kohe per ket kontroll e ka njoftuar dhe nuk e din se ka mundur ndokush me nderhy ndersa ka ushtruar ankes ne KEDS lidhur me këtë qështje per qka eshte duke u zhvilluar procedura kontestimore ndersa lidhur me ndryshimin e faturave per kete kohe nuk e din ngase nuk i bën pagesat e fatures.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së denimit gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konformë nenit 69 të KPRK-së, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se i njejtë për her te par ka rene ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se eshte mbajtes i familjes dhe i moshes se shtyer, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata e vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të t'akuzuarit, pra faktin se i njejtë ne kohen e kryerjes se veprën penale ka qene plotesisht i afte te kuptoj sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese, dhe duke marr per bazë shkallen e rrezikshmeris shoqerore te vepres penale e cila veper eshte në rritje e sipërme ne shoqerin tone Kosovare si dhe faktin se i njejtë është pronar i subjektit ekonomik qe realizon te ardhura në treg (e qe ka mundur te akuzohet edhe subjekti juridik edhe personi fizik pergjegjjes i personit juridik, ngase vjedhja eshte ber ne interes te subjektit), te njejtit i shqiptoi denim me gjobë si në dispozitiv te ketij aktgjykimi duke konsideruar se me denimin e shqiptuar do te arrihet qellimi i denimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj mbrojtjen e të akuzuarit dhe mbrojtjesit te tij mirëpo një mbrojtje të tillë e refuzoj si të pabazuar me arsyetimin se nga provat e administruara më lartë u vërtetua se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe se pretendimi i te akuzuarit se nuk e ka kryer këtë veper është bër me qellim per tiu shmangur pergjegjesisë penale ngase me asnjë provë nuk ka arritur ta argumentoj të kunderten nga ajo që e kishte vertetuar gjykata me provat e vertetuar nga ana e prokurorisë. Gjithashtu gjykata vlerësoi mbrojtjen e mbrojtjesit se njehesori nuk ka pasur nderhyrje fizike dhe nuk është derguar në kalibrim mirëpo një pretendimi te till gjykata nuk i'a fali besimin ngase nderhyrja në oren digjitale siq e kanë arsyetuar deshmitaret e degjuar është ber nderhyrje pa kontakt fizik me ndonjë mjet të adaptuar për ta vën njehesorin jasht funksionit, dhe se derisa ka qenë njehesori i tillë dhe është vërtetuar nga AMR-ja, gjatë kontrolles nga ekipa është konstatuar me mjet të përshtatshem siq kanë qenë amperdanat se energjia elektrike ka qenë duke u shpenzuar ne ato momente siq shihet edhe ne fotodokumentacionin e bërë nga ekipa e kontrolles e qe gjinden ne shkresat e

lendes ku te gjitha fazat kanë qenë duke shpenzuar energji dhe në konsulltim me personat kompetent te AMR-së është ndal sistemi dhe është funksionalizuar perseri në gjendje të rregullt.

Vendimin për shpenzimet e procedures u bazua në nenin 450 par.2 nën par. 6 të KPPK-së, ku ne keto shpenzime janë llogaritur shpenzimet per paushall gjyqësor dhe ne bazë nderlikueshmerise te rastit ne shume prej 50.-€, ndërsa shuma per Fondin e Viktimave te Krimet u bazua ne nenin 39 te këtij ligji.

Ndërsa vendimi për kompenzimin e demit u bazua ne nenin 463 të KPPK-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtijë aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN.

P.nr.217/17me dt.06.11.2020.

Sekretarjajuridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.